Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr.Br. 287/19
Datë/Datum. 10.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 287/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Alfa Group" SH.P.K, & "Fadi Com" SH.P.K, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pemë dhe perime" me nr. prokurimit: UA/2016-18-3787-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/, më datë: 03.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: "Alfa Group" SH.P.K, & "Fadi Com" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pemë dhe perime" me nr. prokurimit: UA/2016-18-3787-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/.

II. **ANULOHET,** njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pemë dhe perime" me nr. prokurimit: UA/2016-18-3787-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Alfa Group" SH.P.K, & "Fadi Com" SH.P.K, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 14.12.2018.
Data e korrigjimit te procedurës është bërë me dt: 20.02.2019
Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 10.01.2019.
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 05.02.2019.
Njoftimi i vendimit për anulim te aktivitetit te prokurimit është bërë me dt: 17.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 30.05.2019.

Grupi i Operatoreve ekonomik ankues: "Alfa Group" SH.P.K, & "Fadi Com" SH.P.K, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.06.2019, me nr.287/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pemë dhe perime" me nr. prokurimit: UA/2016-18-3787-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 56, 65, dhe 71, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 10.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti i jashtëm teknik, në raportin e dt: 21.06.2019, sqaron pretendimet e OE ''ALFA GROUP & "Fadi Com" SH.P.K'', sa i përket eliminimit të datës: 24.05.2019, nga aktiviteti të prokurimit sipas arsyetimit të dhënë nga ana Autoriteti Kontraktues Nuk qëndron arsyeja e eliminimit te konsorciumit ''Alfa Group shpk & Fadi Com'' shpk se autorizimi nuk është plotësuar konform LPP-së, sepse

konsorciumi pjese te ofertës ka dorëzuar të plotësuar dhe nënshkruar siç është kërkuar ne Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit, respektivisht ne pike Trete ku anëtari i konsociumit FadiCom SHPK ka autorizuar si partner kryesor për te vepruar ne emër te grupit liderin Alfa Group SHPK. Dëshmi për Paneli shqyrtues është Deklarata për themelimin e grupit.

Eksperti gjithashtu sqaron se asnjë dispozite e Nenit 71 te LPP-se, Nenit 27 te UOPP dhe Aneksi 6 te kësaj dosje te tenderit Furnizim me Peme dhe Perime, nuk kërkon se partneri kryesor duhet te jete i autorizuar nga anëtari i konsorciumit, por referuar pikës se Trete te Aneksit 6 te DT vetëm kërkohet një deklaratë ku përcaktohet lideri ashtu si e ka ofruar ky konsorcium. Pra deklarata për themelimin e grupit te këtij konsorciumi është ne pajtim te plote me Nenin 71 te LPP-së.

Pasi qe konsorciumi ka ofruar deklaratën për themelimin e grupit ne pajtim me Nenin 71 te LPP-se, vlerësoj se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne pajtim me dosjen e tenderit respektivisht me Aneksin 6, andaj ky vlerësim dhe ekzaminim nuk është ne pajtim me Nenin 59 te LPP-se paragrafi4 "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Për shkak se AK-AQP nuk ka vepruar ne pajtim me kërkesat njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit (Aneksi 6), vlerësoj se konsorciumi është diskriminuar dhe është ne kundërshtim me Nenin 7 te LPP-se paragrafi 1"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Pretendim ankimor i ankuesit i bazuar për shkak se gjendet ne ofertë deklarata e themelimit te grupit.

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar nga OE ankues Lidhur me përgjigjen AK-AQP te dt: 30.05.2019, për anëtarin e konsorciumit se do veproj ne pajtim me Nenin 99.2 te LPP-së, pas përfundimit te këtij aktiviteti te prokurimit, eksperti sqaron si vijon:

Anëtari i konsorciumit ''FadiCom'' SHPK ka dorëzuar tek AK-ja një vërtetim tatimor te datës: 08.02.2019, por i cili vërtetim nuk është ne përputhje me Nenin 65 te LPP-së, sipas AQP-se, eksperti vlerëson se kjo çështje lidhur me ketë vërtetim tatimor janë dy deklarate te anëtarit te konsorciumit si: Deklarata nga Fadil Uka nga ''Fadi Com''shpk dhe nga punëtori Nazim Berisha. Referuar këtyre deklaratave punëtori Z. Berisha thekson se vërtetimin tatimor dt: 08.02.2019, ka nxjerr nga sistemi ATK-së ne pajtim me procedurat dhe nuk ka bere asnjë ndërhyrje ne atë dokument, gjithashtu Përfaqësuesi nga ''Fadi Com'' ofron deklarate ne harmoni me punëtorin e tij te autorizuar për nxjerrjen e vërtetimeve tatimore.

Eksperti sqaron se edhe ne rastin kur është dorëzuar ky vërtetim i datës: 08.02.2019, ne atë rast AK-AQP nuk ka shpërblye me kontrate konsorciumin, përkundrazi ne te dy rastet Autoriteti kontraktues ka

publikuar njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues për anulim te procedurës ne mungese te ofertave te përgjegjshme. Eksperti rekomandon Paneli shqyrtues te merr ne konsiderate deklaratat e lartcekura dhe vërtetimin tatimor te dt: 08.02.2019, te vlerësoj si devijim i vogël ne pajtim me nenin 59 paragrafi 4 Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat,kushtet,dhekërkesatetjeratëparashtruaranënjoftiminekontratësdhenë dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Eksperti sqaron se anëtari i konsorciumit ''FadiCom''shpk sipas dokumenteve ne ankese ka dërguar vërtetimin tjetër tatimor te datës:08.05.2019 i cili vërtetim është ne pajtim te plote me Nenin 65 te LPP-së, i cili nuk është marre ne konsiderate dhe vlerësim dhe ekzaminim nga autoriteti kontraktues.

Eksperti shqyrtues përfundimisht vlerëson se eliminimi i konsorciumit nuk është ne pajtim me kërkesat dhe kriteret e njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit (Deklarata e themelimit te grupit te datës: 10.01.2019, dhe Vërtetimi tatimor datës: 08.05.2019 me numër serik:1000586645) andaj AK-AQP nuk ka vepruar edhe sipas nenit 56 paragrafi 3 te LPP-se "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues OE konsorciumit "Alfa Group" Shpk& "Fadi Com" shpk, të APROVOHET si e bazuara (për arsyen që u ceken tek përgjigja në pretendimet e lartë cekura), njëherit rekomandoj që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RI-VLERËSIM.

Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/, përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 03.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për anulim, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Gjoshi deklaroj: Me dt 24.05.2019, e kemi marr një njoftim qe arsyetim për anulim ne mungesë të tri (3), ofertave të përgjegjshme tenderi te anulohet, neve na kanë vendos te papërgjegjshëm ku deklarata për përcaktimin e liderit te grupit ne e kemi plotësuar edhe aneksi 6 ne te cilin aneks e përcakton edhe liderin e grupit ku është ''Alfa Grup'', ku edhe pika e 3 thotë palete ne këtë deklaratë autorizon ''Alfa Grupin'' si lider te grupit dhe kemi qen te përgjegjshëm. Dhe AK kundër ligjshëm ka anuluar aktivitetin. Përfaqësuesi i OE-së, dorëzoj tri (3) deklarata për vërtetim Tatimor.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Racaj deklaroj: Ne kemi kërkuar për vërtetimin tatimore dhe ATK ka thënë qe nuk përkon me përmbajtjen, me dt 08.05.2019, ne mënyre elektronike sjellin vërtetimin e shlyerjes se borxheve. Çfarë do vlerësimi qe të vjen OSHP ne do të respektojmë. Paragrafi 4 i nenit 65 gjithashtu paragrafi 8 i nenit 26 te RrUOPP-së.
Gjatë prezantimit në seancë eksperti i jashtëm teknik z. Retkoceri deklaroj: Qëndroj prapa raportit te dhëne ne ekspertize.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së, z. Gjoshi deklaroj: Kërkojmë qe ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe te anulohet vendimi i Autoriteti Kontraktues njoftimi për anulim. Dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së, z. Racaj deklaroj: Qëndrojmë pran vendimit te Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se Grupit i operatoreve ekonomik ankues pretendon se është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pa te drejte nga ana e autoritetit kontraktues AQP më datës: 24.05.2019.
Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik sqaron se nuk qëndron arsyeja e eliminimit të konsorciumit ''Alfa Group shpk & Fadi Com'' shpk se autorizimi nuk është plotësuar konform LPP-së, sepse konsorciumi pjese te ofertës ka dorëzuar të plotësuar dhe nënshkruar siç është kërkuar ne Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit, respektivisht ne pike e Trete ku anëtari i konsociumit ''Fadi Com'' SHPK ka autorizuar si partner kryesor për te vepruar ne emër te grupit liderin ''Alfa Group'' SHPK, ku si dëshmi është Deklarata për themelimin e grupit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik sqaron se asnjë dispozite e Nenit 71 te LPP-se, Nenit 27 te RrUOPP dhe Aneksi 6 te kësaj dosje te tenderit Furnizim me Peme dhe Perime, nuk kërkon se partneri kryesor duhet te jete i autorizuar nga anëtari i konsorciumit, por referuar pikës se Trete te Aneksit 6 te DT vetëm kërkohet një deklaratë ku përcaktohet lideri ashtu si e ka ofruar konsorcium në fjalë. Pra deklarata për themelimin e grupit te këtij konsorciumi është ne pajtim te plote me Nenin 71 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik konstaton se pasi qe konsorciumi ka ofruar deklaratën për themelimin e grupit ne pajtim me Nenin 71 te LPP-së, autoriteti kontraktues AQP, nuk ka vepruar ne pajtim me dosjen e tenderit respektivisht me Aneksin 6, andaj ky vlerësim dhe ekzaminim nuk është ne pajtim me Nenin 59 te LPP-së paragrafi 4 në të cilin thuhet *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit "*.
Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik konstaton se AK-AQP, nuk ka vepruar ne pajtim me kërkesat njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit (Aneksi 6), andaj konsorciumi në fjalë është diskriminuar ne kundërshtim me Nenin 7 te LPP-së, paragrafi 1 në të cilin thuhet *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente''*. Prandaj në ofertë të grupit të konsorciumi gjendet deklarata e themelimit te grupit.

Sa i parket pretendimit të OE ankues lidhur me përgjigjen AK-AQP, të dt: 30.05.2019, për anëtarin e konsorciumit se do veproj ne pajtim me Nenin 99.2 te LPP-së, pas përfundimit te këtij aktiviteti te prokurimit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik sqaron se anëtari i konsorciumit ''Fadi Com'' SHPK ka dorëzuar tek AK-ja, një vërtetim tatimor te datës: 08.02.2019, por i cili vërtetim nuk është ne përputhje me Nenin 65 te LPP-së, sipas AQP-së, andaj eksperti i jashtëm teknik vlerëson se kjo çështje lidhur me ketë vërtetim tatimor janë dy deklarate te anëtarit te konsorciumit si: Deklarata nga Fadil Uka nga ''Fadi Com''shpk dhe nga punëtori z. Nazim Berisha. Referuar këtyre deklaratave punëtori z. Berisha, thekson se vërtetimin tatimor i dt: 08.02.2019, ka nxjerr nga sistemi ATK-së, ne pajtim me procedurat dhe nuk ka bere asnjë ndërhyrje ne atë dokument, gjithashtu Përfaqësuesi nga ''Fadi Com'' ofron deklarate ne harmoni me punëtorin e tij te autorizuar për nxjerrjen e vërtetimeve tatimore.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik sqaron se edhe ne rastin kur është dorëzuar ky vërtetim i datës: 08.02.2019, ne atë rast AK-AQP, nuk ka shpërblye me kontrate konsorciumin, përkundrazi ne te dy rastet Autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues për anulim te procedurës ne mungese te ofertave te përgjegjshme. Prandaj paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik vlerëson se duhet te merr ne konsiderate deklaratat e lartcekura dhe vërtetimin tatimor te dt: 08.02.2019, dhe vlerësohen si devijim i vogël ne pajtim me nenin 59 paragrafi 4 Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet,dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve" Lidhur me këtë pretendim te AK-AQP-së, Paneli shqyrtues konstaton se nuk është konstatuar apo edhe nuk ka vendim nga asnjë organ qe vetëton se ka patur ndërhyrje ne atë vërtetim.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik konstaton se anëtari i konsorciumit ''FadiCom''shpk sipas dokumenteve ne ankese ka dërguar vërtetimin tjetër tatimor te datës: 08.05.2019, i cili vërtetim është ne pajtim te plote me Nenin 65 te LPP-së, i cili nuk është marre ne konsiderate dhe vlerësim dhe ekzaminim nga autoriteti kontraktues. Prandaj eliminimi i konsorciumit në fjalë nuk është ne pajtim me kërkesat dhe kriteret e njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit (Deklarata e themelimit te grupit te datës: 10.01.2019, dhe Vërtetimi tatimor datës: 08.05.2019 me numër serik:1000586645) andaj AK-AQP nuk ka vepruar edhe sipas nenit 56 paragrafi 3 te LPP-së në të cilin thuhet *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

Paneli shqyrtues duke u nisur nga të dhënat si me lart vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit te prokurimit në fjalë është bëre në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Prandaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë aktivitetet të prokurimit dhe kërkesave të dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të

shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim Dina

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/

1x1 OE -"Alfa Group" SH.P.K, & "Fadi Com" SH.P.K

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.